

NË EMËR TË POPULLIT

Gjykata e Apelit e Kosovës - Departamenti për krime të rënda, në kolegjin e përbërë nga gjyqtarët Xhevdet Abazi, kryetar i kolegjit, Abdullah Ahmeti dhe Afrim Shala, anëtarë, me bashkëpunëtoren profesionale Syzana Goxhulli, si procesmbajtëse, në lëndën penale kundër të akuzuarit S.ZH., për shkak të veprës penale Keqpërdorim i se drejtës se votimit, nga neni 216 par.1 nen,par.1.2 te KPRK-se, duke vendosur sipas ankesës së Prokurorisë Themelore në Prishtinë të ushtruar kundër aktgjykimit të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.156/2017 të datës 30.11.2018, në seancën e kolegjit të mbajtur me datën **08. Shkurt. 2019**, mori këtë:

AKT GJYKIM

REFUZOHET si e **pabazuar** ankesa e Prokurorisë Themelore në Prishtinë, ndërsa aktgjykimi i Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr.156/2017 të datës 30.11.2018, **VËRTETOHET**.

Arsyetim

Me aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë PKR.nr 156/2017 të datës 30.11.2018 ,e në bazë të nenit 364 par.1 nënpar.1.3 dhe nenit 454 të KPPRK-së i akuzuari S.ZH. në mungesë të provave është liruar nga akuza për shkak të veprës penale, Keqpërdorim i se drejtës se votimit, nga neni 216 par.1 nen,par.1.2 te KPRK-se.

Gjithashtu është vendosur që shpenzimet e procedurës penale lidhur me këtë çështje penale të bien në barrë të mjeteve buxhetore të Gjykatës.

Kundër këtij aktgjykimi, në afatin ligjor ankesë ka ushtruar:

Prokuroria Themelore në Prishtinë , për shkak të shkeljes se ligjit penal dhe vërtetimit te gabuar ose jo te plote te gjendjes faktike, me propozim që Gjykata e Apelit e Kosovës aktgjykimin e atakuar të Gjykatës Themelore në Prishtinë ta ndryshoj ne atë mënyre qe te pandehurin ta shpall fajtor për këtë vepër penale dhe ti shqiptoj dënimin me burgim, ose ta anuloj dhe çështjen te ja kthej Gjykatës se shkalles se pare ne rigjykim dhe vendosje.

Prokurori i Apelit i Kosovës, duke u skjaruar përkitazi me ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë , me shkresën e vet PPA.I.nr.37/19 të datës 23.01.2019 ka propozuar që Gjykata e Apelit e Kosovës ankesën e Prokurorisë Themelore në Prishtinë ta aprovoj si të bazuar, ashtu që aktgjykimin e atakuar ta anuloj dhe çështjen t'ia kthej Gjykatës së shkallës së parë në rigjykim dhe vendosje

Gjykata e Apelit e Kosovës, konform nenit 394 par.1.të KPPRK-së shqyrtoi shkresat e lëndës, vlerësoi aktgjykimin e ankimuar, si dhe pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore në Prishtinë dhe gjeti se:

-Ankesa nuk është e bazuar.

Me ankesën e Prokurorisë Themelore ne Prishtinë pretendohet se Gjykata e shkallës së parë nuk e ka vërtetuar në mënyrë të plotë dhe të drejtë gjendjen faktike kur të akuzuarin S.ZH. e ka liruar nga akuza në mungesë të provave për shkak të veprës penale Keqpërdorim i së drejtës së votimit, nga neni 216 par.1 nen.par.1.2 të KPRK-se. Sipas pretendimeve ankimore të Prokurorisë, gjykata e shkallës së parë nuk është dashur që t'ia fal besimin vetëm mbrojtjes të pandehurit S.ZH. se ditën kritike ia ka dhënë letërnjoftimin një personi që nuk ia din emrin e që është sekretar i partisë LS, e kinse letërnjoftimin i njëjti ia ka dhënë për ta punësuar dhe të sigurojnë me shume vota.

Sipas Gjykatës së Apelit pretendimet ankimore të Prokurorisë Themelore ne Prishtinë nuk janë të bazuara ngase nga shkresat e lëndës dhe aktgjykimi i ankimuar vërtetohet se i akuzuari si votues i rregullt ka votuar me datë 08.06.2014 në zgjedhjet e përgjithshme në Kosovë , në fshatin Gushterice e ulët Komuna e Graçanicës dhe se nuk është arritur që të vërtetohet se i njëjti të ketë votuar në ndonjë vendvotim tjetër me kusht ngase nga vendvotimi tjetër pas administrimit të provave Gjykata e shkallës së parë ka ardhur në përfundim se ka qenë tjetër nënshkrim në regjistra të votimit e jo nënshkrimin të cilin e ka dhënë i akuzuari në vendvotimin e rregullt. Se nuk ka votuar në tjetër vendvotim i akuzuari ka dhënë deklaratë bindëse para Gjykatës së shkallës së parë të cilës Gjykata i ka besuar ndërsa sa i përket votimit me kusht këtu ka mund ta bëjë ndonjë person tjetër në emër të të akuzuarit duke e shfrytëzuar letërnjoftimin e tij e i cili ka deklaruar se letërnjoftimin ia ka dhënë një personi për të ndihmuar në punësim e që kjo nuk paraqet ndonjë vepër penale konkrete.

Gjykata e Apelit e aprovon gjendjen e vërtetuar faktike nga ana e Gjykatës së shkallës së parë në bazë të se cilës ka nxjerrur aktgjykim lirues për të akuzuarin ngase nuk ka mund të vërtetohet se i akuzuari të ketë votuar edhe si votues i rregullt edhe me kusht, e nga kjo del se në rastin konkret drejt e ka aplikuar edhe ligjin penal kur ka nxjerr aktgjykim lirues në mungesë të provave.

Gjykata e Apelit gjeti se aktgjykimi i ankimuar nuk përmban as shkelje esenciale të dispozitave të procedurës penale të cilat i konstaton sipas detyrës zyrtare.

Nga arsyet e cekura më lartë, e në bazë të nenit 401 të Kodit të Procedurës Penale të Kosovës u vendos si në dispozitiv të këtij aktgjykimi.

GJYKATA E APELIT E KOSOVËS
PAKR.nr.23/19, më 08.02.2019

Procesmbajtëse
Syzana Goxhuli

Anëtarët e kolegjit
Abdullah Ahmeti

Kryetari i kolegjit,
Xhevdet Abazi

Afrim Shala
